



Dr. Teuta THANASI (BITI)
Head of Mathematics Department
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
Universiteti “Aleksander Moisiu”
✉ teutathanasi@uamd.edu.al
Durrës, Albania

Short Bio
Albanian

Dr. Teuta THANASI (BITI) është që prej 5 vitesh shefe e Departamentit të Matematikës në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës si dhe lektore (profesore) e kurseve të ndryshme të matematikës pranë këtij universiteti. Ajo është diplomuar në bachelor për Matematikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës. Më vonë për të plotësuar ambiciet akademike, zonja Thanasi u diplomua në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Ekonomisë dega Administrim - Biznes. Ky diplomim i shërbeu si një shkallë për të kryer Masterin në Administrim Biznesi po në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës. Zonja THANASI ka qenë shumë e prirur dhe plot pasion përsa i përket ekonomisë dhe paradigmave matematike përkatëse. Me zell dhe me shumë punë ajo mbrojti tezën e doktoraturës në “Kërkime operacionale” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës. Në punimin e saj shkencor u kombinuan suksesshëm metodat e modelimit statistikor me analizën e të dhënave për të bërë një parashikim të ecurisë së remitancave në Shqipëri, duke pasur parasysh ndikimin, që kanë këto remitanca në GDP-në e Shqipërisë.

Që nga viti 2007 Dr. THANASI punon pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” të Durrësit, në fillim si lektore e jashtme dhe që nga viti 2012 si profesoreshë full time në kurset e ndryshme të matematikës . Gjatë karrierës së saj, Dr. THANASI gjithnjë ka qenë e fokusuar plot pasion për përmirësimin e cilësisë së arsimit të mesëm dhe të lartë. Në vitet 2016-2020 ka qenë edhe anëtare e Senatit Akademik të universitetit organizëm ky, që mbulon formulimin e politikave akademike të universitetit. Po ashtu zonja THANASI ka qenë anëtare e bordit të pranimit të teksteve të matematikës, që përdoren nga studentë dhe nxënës të cikleve të ndryshme të arsimit. Dr. THANASI është edhe bashkë autore e disa teksteve të matematikës, që përdoren nga nxënës dhe studentë të cikleve të ndryshme. Ajo ka kontribuar në komunitetin shkencor jo vetëm duke qenë pjesë e këtij komuniteti dhe me botimin e kërkimeve të saja, në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, por edhe duke qenë anëtare e bordit organizues, duke drejtuar konferenca shkencore ndërkombëtare të mbajtura në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Elbasan, Pejë, etj. Gjithashtu, ajo ka qenë pjesë e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare të fokusuara në inovacionin dhe zhvillimin e metodologjive të reja mësimore në matematikë dhe edukim. Përveç kësaj, Dr. THANASI ka marrë pjesë aktivisht si trajnuese në programe të trajnimit të mësuesve të matimatikes të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë, duke kontribuar në zhvillimin profesional dhe shkencor të tyre.

Dr. Teuta THANASI (BITI)